



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Ferizaj / Osnovno Tužilaštvo Ferizaj / Ferizaj Basic Prosecution

AD.nr.2/25

Datë: 06.02.2025

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, duke vendosur lidhur me ankesën-kërkesë për inicim të procedurës disiplinore, të paraqitur nga [redacted], kundër Prokurorit të Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, [redacted], në bazë të nenit 9 paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6, të Ligjit Nr. 06/L - 057, për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, merr:

V E N D I M

HUDHET, ankesa-kërkesa për inicim të procedurës disiplinore, të paraqitur nga [redacted], kundër Prokurorit të Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj [redacted], ngase me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer ndonjë shkelje disiplinore, nga neni 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-057, për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me datë 17.01.2025, nga [redacted] ka pranuar ankesë-kërkesë për inicim të procedurës disiplinore kundër Prokurorit të Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, [redacted].

Ankuesi [redacted] përmes ankesës së tij të paraqitur, pretendon se Prokurori [redacted] ka kryer shkelje disiplinore në lëndën me numër [redacted], ashtu që me datë 28.01.2022 i njëjti është kontaktuar nga zyrtarët policor të Stacionit Policor Hani i Elezit si prokuror kujdestar, për ta njoftuar se [redacted] ka raportuar rast kundër [redacted] dhe [redacted] me pretendimet për uzurpim prone. Me atë rast prokurori kujdestar [redacted] i ka udhëzuar hetuesit policor në ndërmarrjen e veprimeve hetimore dhe përgatitjen e kallëzimit penal pastaj dorëzimin e tij pranë Prokurorisë.

Tutje në ankesën e tij, ankuesi ka theksuar se po atë datë me 28.01.2022 përmes telefonit është kontaktuar nga zyrtari policor për t'u paraqitur në Stacionin Policor Hani i Elezit për dhënien e deklaratës, ku edhe kupton për kallëzimin penal të paraqitur ndaj tij për uzurpim prone, i cili kallëzim penal sipas ankuesit është veprim i qëllimshëm nga Prokurori i Shtetit [redacted] për ta dëmtuar materialisht dhe jo materialisht të njëjtin.

Pas pranimit dhe analizimit të ankesës-kërkesës për inicim të procedurës disiplinore, të paraqitur nga ana e ankuesit, konsiderojmë se pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë për faktin se:

Bazuar në shkresat e lëndës [redacted] rezulton se në kohën kur është raportuar rasti Prokurori i Shtetit, [redacted] ka qenë kujdestar javor, ku i njëjti i është përgjigjur zyrtarëve policor nga Hani i Elezit për ankesën e paraqitur nga qytetari - në atë rast i dëmtuari [redacted] për uzurpim prone, dhe të njëjtit zyrtar policor i ka udhëzuar në ndërmarrjen e veprimeve hetimore, ndërsa me të përfunduar me veprimet hetimore lënda të dorëzohet me kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, pranë Departamentit të Përgjithshëm, e cila lëndë pastaj është regjistruar tek Prokurorja [redacted] dhe ka rezultuar me ngritjen e aktakuzës ndaj të pandehurve [redacted], pasi që kishte ekzistuar dyshimi i bazuar mirë se në veprimet e të njëjtëve janë përmbushur elementet qenësore të veprës penale në bashkëkryerje Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, vepër kjo e cila nuk është e dënueshme me më shumë se tri vjet burgim.

Nga të lartcekurat dhe pas vlerësimit të kërkesë për inicim të procedurës disiplinore së lartcekur, është konstatuar se në rastin konkret nuk ekziston asnjë shkelje disiplinore, e paraparë nga neni 6 paragrafi 1 dhe 2 të ligjit Nr. 06/L - 057, për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pasi që Prokurori i Shtetit ka vendosur për çështjen konform dispozitave ligjore.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Të njoftohet:

- Këshilli Prokurorial i Kosovës.
- Pala ankuese

